



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0225

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi dhe Batisha Ibrahim - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE LIMITPROJECT SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konservimi dhe Zhvillimi i Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut- Klinë” me numër të prokurimit 207-25-9889-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, më 03/06/2026, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjeserisht e bazuar ankesa e LIMITPROJECT SH.P.K. me nr. 2026/0225, e datës 08/04/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konservimi dhe Zhvillimi i Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut- Klinë”, me numër të prokurimit 207-25-9889-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

2. **Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK për aktivitetin e prokurimit “Konservimi dhe Zhvillimi i Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut- Klinë”, me numër të prokurimit 207-25-9889-5-1-1.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.11.2025 MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK,, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Konservimi dhe Zhvillimi i Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut- Klinë” me numër

të prokurimit 207-25-9889-5-1-1,

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 2,479,822.44€.

Me 17.03.2026 MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin mbi vendimin e AK (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE “100% Design Shpk & Termomontimi Shpk”.

Me 23.03.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 31.03.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.04.2026, OEAS Tech SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0225, duke e atakuar Vendimin për dhenie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues LIMITPROJECT SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 1: LPP-së Qëllimi

Neni 7: Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 10: Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60: Kriteret për dhënie të Kontratës

Neni 72: Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

A01. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 40: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

A02. Udhëzues Nr.001/2023 për Prokurimin Publik

Specifikisht të neneve:

Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi dhe Fushëveprimi i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik

Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve.

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoritetit kontraktues në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen në aktivitetin e prokurimit ose që përfshihen për shkak se kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Kulturës, RS dhe ÇJK, me datën 06.11.2025, ka publikuar në e-prokurim dosjen e tenderit me titull: "Konservimi dhe Zhvillimi i Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut Klinë", me numër të prokurimit 207-25-9889-5-1-1. Me datën 17.03.2026 AK ka publikuar vendimin e tij, në të cilin ka shpallur fitues konzorciumin: GOE: N.N 100% Design shpk, Termomontimi shpk, me vlerën: 2,276,064.20 €. Në po të njëjtën ditë kemi parashtruar kërkesën për qasje në dokumente, e cila qasje na është aprovuar më 18.03.2026. Me 23.03.2026 kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim, për të cilën me datën 31.03.2026 është kthyer vendimi me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim si e pabazuar.

Ka shkelur Nenin 7 – Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim

Ne, operatori ekonomik "LIMIT PROJECT SHPK", besojmë që Autoriteti Kontraktues: Ministria e Kulturës, RS dhe ÇJK, është në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, nga vetë fakti që ligji nuk e mohon pjesëmarrjen e asnjë kompanie për procedura tenderuese.

Pretendimet lidhur me OE të suksesshëm:

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Kulturës, RS dhe ÇJK, me datën 17.03.2026 ka shpallur fitues GOE: N.N 100% Design shpk, Termomontimi shpk, me vlerën: 2,276,064.20 €.

Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare është bërë me datën 17.03.2026. Qasja na është ofruar me datën 18.03.2026 dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të GOE-së dyshojmë se nuk i plotëson kërkesat sipas FTD-së.

Sipas Dosjes së Tenderit:

Kërkesa nr. 2 – Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit që operatori ekonomik nuk ka vonesa në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit (vetëm për fituesin).

Dhe

Kërkesa nr. 3 – Vërtetim nga Gjykata kompetente që operatori ekonomik përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit (original ose kopje, vetëm për fituesin).

Në rastin konkret:

Data e dorëzimit të njoftimit të kontratës në KRPP: 06.11.2025

Dosja e tenderit është dorëzuar më 23.12.2025

Autoriteti Kontraktues (AK) ka kërkuar këto dokumente më 23.01.2026

Ndërsa vendimi për shpalljen e fituesit është nxjerrë më 17.03.2026

Dyshimi:

Dokumentet e dorëzuara nga OE fitues nuk mund të jenë të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës, pasi kërkesat për vërtetimet tatimore dhe gjyqësore ishin të lidhura me situatën para shpalljes së fituesit, dhe procedura ka tejkaluar tre muaj nga dorëzimi origjinal.

Kjo periudhë kohore tregon se dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik fitues mund të mos kenë qenë të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertës, duke ngritur dyshime serioze mbi përmbushjen e Kërkesave nr. 2 dhe 3 (vërtetimet tatimore dhe gjyqësore).

Kjo ngre dyshime serioze nëse OE i rekomanduar nuk përmbush Kërkesat 2 dhe 3, duke rrezikuar ligjshmërinë e vendimit për dhënie të kontratës.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Qarkullimi

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka kërkuar shprehimisht që OE/GOE të ketë qarkullim për tri vitet e fundit në vlerën 4,959,000.00 €, dhe kjo duhet të dëshmohet me kopje të deklaratave tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit ose raportet e pasqyrave të audituara.

Megjithatë, GOE i shpallur fitues dyshojmë se nuk e plotëson kriterin e qarkullimit për tri vitet e fundit në vlerën e parashikuar nga AK. Një vlerësim i tillë përbën zbatim jo-konsistent dhe selektiv të kriterëve të Dosjes së Tenderit, pasi kriteri kërkon përmbushje të të gjitha kriterëve.

Ky veprim bie ndesh me Nenin 59 të LPP-së, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të vlerësojë ofertat në përputhje strikte me kërkesat e Dosjes së Tenderit, si dhe cenon Nenin 7 dhe Nenin 1 të LPP-së, duke krijuar trajtim të pabarabartë dhe duke cenuar transparencën dhe konkurrencën e drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik të shpallur fitues rezulton se kjo ofertë paraqet mospërputhje të shumëfishta dhe substanciale me kërkesat e Dosjes së Tenderit, përfshirë, por pa u kufizuar në kategoritë në vijim:

Këto mangësi cenojnë vlefshmërinë formale të ofertës dhe bien ndesh me detyrimin e Autoritetit Kontraktues për të vlerësuar vetëm ofertat që përmbushin kërkesat e Dosjes së Tenderit, në kuptim të Nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe parimin e transparencës sipas Nenit 1 të LPP-së.

D. Staf i kyç – përvoja dhe kualifikimet profesionale

Sipas Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë disponueshmërinë e stafit profesional si në vijim:

Inxhinier i Arkitekturës

Inxhinier i Ndërtimtarisë – konstruktiv

Inxhinier i Ndërtimtarisë – hidroteknik

Inxhinier i Elektroteknikës

Inxhinier i Makinerisë

Arkeolog me licencë A4

Nga dokumentacioni i ofruar (qasje e pjesshme), ekzistojnë dyshime që operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush këtë kriter, konkretisht:

Ka mungesë të dëshmisë për Arkeolog me licencë valide A4

Ka paqartësi mbi përmbushjen e plotë të listës së stafit të kërkuar

Duke qenë se ky kriter është kriter thelbësor për kapacitetin teknik dhe profesional, mosplotësimi i tij duhet të rezultojë me diskualifikim të operatorit ekonomik.

Gjithashtu, në Dosjen e Tenderit është përcaktuar se:

Operatorët Ekonomikë nuk duhet të kenë më shumë se tri (3) kontrata aktive me MKRS të natyrës së njëjtë, dhe një staf i licencuar nuk mund të jetë i angazhuar në më shumë se tri kontrata në të njëjtën kohë.

Andaj, ekzistojnë dyshime se grupi i operatorëve ekonomikë të shpallur fitues:

Mund të ketë më shumë se tri kontrata aktive me MKRS duke përdorur stafin e njëjtë të licencuar

Mund të ketë të njëjtin staf të licencuar të angazhuar në disa projekte njëkohësisht

Nëse kjo konfirmohet, atëherë kemi shkelje direkte të kërkesës së Dosjes së Tenderit dhe, për rrjedhojë, ofertë jo të përgjegjshme.

Këto mangësi përbëjnë mospërmbushje të kriterëve të kualifikimit profesional dhe teknik, në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së dhe parimin e trajtimit të barabartë sipas Nenit 7 të LPP-së.

Këto mangësi përbëjnë mospërmbushje të kriterëve teknike dhe profesionale, dhe cenojnë parimin e transparencës dhe proporcionalitetin në vlerësimin e ofertave, në kundërshtim me Nenin 1 dhe Nenin 59 të LPP-së.

Sipas Dosjes së Tenderit (Kriteri nr. 4), operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një listë të vulosur dhe të nënshkruar, e cila të përmbajë 20 punëtorë profesionalë dhe mbështetës, me të dhëna të plota për emrin, mbiemrin, të dhënat personale, përvojën dhe funksionin në projekt, duke përfshirë:

Armirus

Latues

Ajustator

Saldues

Punues të pllakave

Punues të llamarinës

Instalues të ujësjellësit dhe kanalizimit

Murator

Manipulues të makinerisë

Kranist

Instalues elektrik

Instalues të ngrohjes dhe klimatizimit

10 punëtorë fizikë

Ekzistojnë dyshime se grupi i operatorëve ekonomikë i shpallur fitues nuk e plotëson këtë kriter të Dosjes së Tenderit edhe pas sqarimeve të kërkuara nga AK. Me datën 19.01.2026 AK ka kërkuar sqarim për stafin teknik për armirues dhe për latues, pasi që GOE nuk i ka dorëzuar dokumentet sipas kërkesës së FTD-së, që janë diplomat e shkollës së mesme, por kanë dorëzuar vetëm certifikime, të cilat nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara për këto pika.

Kjo tregon se operatori ekonomik nuk e përmbush Kriterin nr. 4, duke e bërë ofertën e tij jo të përgjegjshme në këtë pjesë, edhe pas kërkesës për sqarim të bërë nga Autoriteti Kontraktues.

Lista e pajisjeve

Sipas Dosjes së Tenderit (Kriteri nr. 5), operatori ekonomik duhet të paraqesë një listë të pajisjeve që do të përdoren në projekt, duke përfshirë:

Kamionetë

Kamion kiper me kran – 1 copë

Skele minimum 300m²

Një gjenerator (agregat)

Nga informacionet dhe dokumentacioni i dhënë gjatë procedurës, ekziston dyshimi se grupi i operatorëve ekonomikë i shpallur fitues nuk i plotëson këto kërkesa të pajisjeve në mënyrë të plotë dhe sipas kriterëve të parashikuara në Dosjen e Tenderit.

Ky dyshim, në kombinim me mospërmbushjen e kriterëve për staf dhe dokumentacionin tatimor, tregon se oferta e operatorit ekonomik është jo e përgjegjshme, duke cenuar konkurrencën e drejtë dhe transparencën e procedurës.

Përfundim juridik:

Shkeljet e mësipërme nuk janë të natyrës formale, por janë shkelje materiale dhe kumulative, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përgjegjshmërinë e ofertës së GOE të shpallur fitues. Si të tilla, oferta nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme në kuptim të Nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, dhe pranimi i saj cenon parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë, të përcaktuara në Nenet 1 dhe 7 të këtij ligji.

Duke i parë shkeljet e paraqitura në detaje të:

A. Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

B. A01. Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

C. A02. Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik

I propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit “OSHP”:

Ankesën e paraqitur nga LIMIT PROJECT SHPK ta vlerësojë si të bazuar.

Aktivitetin e prokurimit: “Konservimi dhe Zhvillimi i Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut – Klinë” ta kthejë në RIVLERËSIM dhe të marrë vendim se OE i vetëm i përgjegjshëm dhe i suksesshëm është konzorciumi ynë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimi nr. 1

Kërkesë për rishqyrtim nga OE: LIMIT PROJECT SH.P.K

Aktiviteti i prokurimit: Konservimi dhe Zhvillimi i Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut – Klinë

Nr. prokurimit: 207-25-9889-5-1-1 dhe 207-25-120-5-1-1

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe ÇJK, me datë 17.03.2026, kanë shpallur fitues Grupin e Operatorëve Ekonomik (GOE): N.N. 100% Design SH.P.K & Termomontimi SH.P.K, me vlerë të kontratës 2,276,064.20 €.

Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare është bërë me datë 17.03.2026, ndërsa qasja është ofruar me datë 18.03.2026. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të GOE të shpallur fitues, OE ankues pretendon se i njëjti nuk i plotëson kërkesat sipas Dosjes së Tenderit (FTD).

1. Pretendimet lidhur me vërtetimet tatimore dhe gjyqësore (Kërkesat nr. 2 dhe 3)

Sipas Dosjes së Tenderit është kërkuar:

Kërkesa nr. 2

Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit që operatori ekonomik nuk ka vonesa në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit (vetëm për fituesin).

Kërkesa nr. 3

Vërtetim nga Gjykata kompetente që operatori ekonomik përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, i lëshuar në original ose kopje, së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit (vetëm për fituesin).

Në rastin konkret:

Afati për dorëzim të ofertave: 23.12.2025

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar dokumentet: 23.01.2026

Vendimi për shpalljen e fituesit: 17.03.2026

OE ankues pretendon se dokumentet e dorëzuara nga OE fitues nuk mund të kenë qenë valide në momentin e dorëzimit të ofertës, pasi procedura ka tejkaluar periudhën tremujore nga data e dorëzimit të ofertave. Sipas ankuesit, kjo krijon dyshime serioze mbi përmbushjen e kërkesave nr. 2 dhe 3 dhe rrezikon ligjshmërinë e vendimit për dhënie të kontratës.

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar – Qarkullimi

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kërkuar që OE/GOE të ketë qarkullim për tri vitet e fundit në vlerë minimale prej 4,959,000.00 €, i dëshmuar përmes deklaratave tatimore vjetore ose pasqyrave financiare të audituara.

OE ankues pretendon se GOE i shpallur fitues nuk e plotëson këtë kriter dhe se një vlerësim i tillë përbën zbatim jo konsistent dhe selektiv të kriterëve të Dosjes së Tenderit, në kundërshtim me:

Nenin 59 të LPP-së (vlerësimi strikt sipas FTD)

Nenin 7 dhe Nenin 1 të LPP-së (barazia dhe transparenca)

Ankuesi pretendon se oferta e OE të shpallur fitues përmban mospërputhje të shumta dhe substanciale me kërkesat e Dosjes së Tenderit, të cilat cenojnë vlefshmërinë formale të ofertës.

3. Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues

Pretendimi refuzohet si i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues ka verifikuar formularët tatimorë të të dy kompanive në kuadër të GOE dhe ka konstatuar se qarkullimi financiar i tyre është rreth 7,000,000 €, respektivisht 1.95 milion € më shumë se kërkesa minimale e Dosjes së Tenderit. Për rrjedhojë, kriteri i qarkullimit financiar është përmbushur plotësisht.

Sa i përket vërtetimeve të ATK-së, të dy kompanitë kanë dorëzuar vërtetime valide:

100% Design SH.P.K

Data e lëshimit: 26.02.2026

Arsyeja: Aplikim për tender

Nr. serik: 1001324292

Termomontimi SH.P.K

Data e lëshimit: 27.01.2026

Arsyeja: Aplikim për tender

Nr. serik: 1001316128

Këto vërtetime dëshmojnë se operatorët ekonomikë të shpallur fitues nuk kanë borxhe tatimore.

4. Staf i profesional dhe arkeologu me licencë A4

Sipas Dosjes së Tenderit, OE duhet të dëshmojë disponueshmërinë e stafit profesional si në vijim:

Inxhinier i Arkitekturës

Inxhinier i Ndërtimtarisë – konstruktiv

Inxhinier i Ndërtimtarisë – hidroteknik

Inxhinier i Elektroteknikës

Inxhinier i Makinerisë

Arkeolog me licencë A4

OE ankues pretendon se:

Mungon dëshmia për arkeolog me licencë valide A4

Ka paqartësi për plotësimin e listës së stafit

Ekziston dyshim për tejkalim të kufirit prej 3 kontratave aktive me MKRS dhe përdorim të stafit të njëjtë në disa projekte njëkohësisht.

Sipas ankuesit, nëse kjo konfirmohet, kemi shkelje të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe mos-përmbyllje të kriterëve të kapacitetit profesional dhe teknik në kundërshtim me nenin 59 dhe nenin 7 të LPP-së.

Këto mangësi përbëjnë mos-përmbyllje të kriterëve teknike dhe profesionale dhe cenojnë parimin e transparencës dhe proporcionalitetit në vlerësimin e ofertave, në kundërshtim me Nenin 1 dhe Nenin 40 të LPP-së.

Refuzohet pretendimi ankimor si i pabazuar: Autoriteti Kontraktues ka trajtuar dokumentacionin dhe pretendimet, dhe konstaton se Grupi i Operatorëve Ekonomik ka paraqitur staf të licencuar i cili është i angazhuar në më pak se tri kontrata. I njëjti ka bashkëngjitur edhe Arkeolog me licencë valide dhe me vërtetim sipas Licencës A4, i cili është Arkeolog dhe Master i Arkeologjisë, pikërisht ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit. I gjithë stafi ka plotësuar kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit.

Sipas Dosjes së Tenderit (Kriteri nr. 4), operatori ekonomik duhet të paraqesë një listë të vulosur dhe të nënshkruar, e cila duhet të përmbajë së paku 20 punëtorë profesionalë dhe mbështetës, me të dhëna të plota për emër, mbiemër, të dhëna personale, përvojë dhe funksion në projekt, duke përfshirë: armirues, latues, agjustator, saldues, punues të pllakave, llamarinë-punues, instalues të ujësjellësit dhe kanalizimit, murator, manipulues të makinerisë, kranist, instalues elektrik, instalues të ngrohjes dhe klimatizimit si dhe 10 punëtorë fizikë.

Ekzistojnë dyshime se Grupi i Operatorëve Ekonomik i shpallur fitues nuk e plotëson këtë kriter të Dosjes së Tenderit edhe pas sqarimeve të kërkuara nga AK. Më datë 19.01.2026, AK ka kërkuar sqarime për stafin teknik për armirues dhe latues, pasi GOE nuk kishte dorëzuar dokumentacionin sipas kërkesave të FTD-së, përkatësisht diplomat e shkollës së mesme, por kishte dorëzuar vetëm certifikime që nuk i plotësonin kërkesat e përcaktuara për këto pozita. Kjo tregon se operatori ekonomik nuk e përmbush Kriterin nr. 4, duke e bërë ofertën të papërgjegjshme në këtë pjesë edhe pas kërkesës për sqarim të bërë nga Autoriteti Kontraktues.

Pretendimi nuk qëndron, pasi Grupi i Operatorëve Ekonomik e plotëson kriterin si vijon:

Kriteri nr. 4: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një listë të vulosur dhe të nënshkruar me së paku 20 punëtorë teknikë profesionalë dhe mbështetës. Lista duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin, të dhënat personale, eksperiencën dhe funksionin brenda kompanisë apo punët që do të kryhen në projekt:

- 4.1. Së paku 1 armirues
- 4.2. Së paku 1 latues
- 4.3. Së paku 1 agjustator
- 4.4. Së paku 1 saldues
- 4.5. Së paku 1 punues të pllakave
- 4.6. Së paku 1 llamarinë-punues
- 4.7. Së paku 1 instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit
- 4.8. Së paku 1 murator
- 4.9. Së paku 1 manipulues i makinerisë
- 4.10. Së paku 1 kranist
- 4.11. Së paku 1 instalues elektrik
- 4.12. Së paku 1 instalues i ngrohjes dhe klimatizimit
- 4.13. Së paku 10 punëtorë fizikë

Për stafin 4.1 dhe 4.2 duhet të paraqiten diplomat e shkollimit të mesëm (të pranueshme edhe të ndërtimtarisë dhe arkitekturës), së paku 3 vite përvojë pune (të dëshmuar me CV të nënshkruar) dhe së paku një referencë në trashëgimi kulturore ose punë të ngjashme, si dhe kontrata ose parakontrata e punës e nënshkruar nga dy palët dhe e vulosur nga OE. Për stafin 4.3 dhe 4.4

kërkohet kontrata ose parakontrata e punës. Për stafin 4.5 kërkohet përvojë pune së paku 3 vite dhe kontrata ose parakontrata e punës. Për stafin 4.6 kërkohen kontrata ose parakontrata e punës.

Lista e pajisjeve

Sipas Dosjes së Tenderit (Kriteri nr. 5), operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e pajisjeve që do të përdoren në projekt, duke përfshirë: kamionetë, kamion kiper me kran, skele minimum 300 m² dhe një gjenerator (agregat). Ekzistojnë dyshime se GOE i shpallur fitues nuk i plotëson këto kërkesa në mënyrë të plotë.

Pretendimi nuk qëndron, pasi GOE ka paraqitur:

- Kamionetë dhe kamion me kran me libreza valide;
- Për skele dhe gjenerator ka bashkëngjitur fatura të blerjes ose kontrata të huazimit, duke dëshmuar se janë në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Procedura “Konservimi dhe Zhvillimi i Lokalitetit Arkeologjik të Dresnikut – Klinë” krahasuar me procedurat tjera në trashëgimi kulturore ka pasur të njëjtat kritere, me shtimin e një arkeologu për shkak të nevojës për ndërhyrje arkeologjike në Dresnik. Të gjitha kriteret janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret e prokurimit publik. Me kritere të ngjashme, edhe ju jeni shpallur fitues në procedura të tjera. Në këtë procedurë, Grupi i Operatorëve Ekonomik fitues ka ofertë rreth 200,000.00 € më të lirë se oferta juaj, dhe Autoriteti Kontraktues synon të shpërblejë me kontratë operatorët që i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kanë ofertën më të lirë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 16.04.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0225, ndërsa me datë 27.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0225, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OELIMITPROJECT SH.P.K, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0225 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Konservimi dhe Zhvillimi i Lokalitetit Arkeologjik te Dresnikut- Kline” me nr. të prokurimit: "207-25-9889-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshme.

Ankesa është e parashtruar kundër Njoftimi B58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

OE ankues është shpallë i pasuksesshëm me çmimin më të lartë se sa OE i rekomanduar.

OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, i njëjti parashtroi ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), duke pretenduar se AK gjatë vlerësimit të ofertave shkelë Ligjin e Prokurimit Publik përkatësisht nenet: 1,7,10,59,60,72, Rregulloren për Prokurim Publik neni 40 dhe Udhëzuesin nr. 001/2023 për Prokurim Publik nenet 1 dhe 10.

(Shënim: Pretendimet e ankesës janë të përshkruara lartë tek pjesa Dispozitat e Shkelura dhe Pretendimet Ankimore).

Tutje, OE ankues në ankesë pretendon se AK nuk ka dhënë qasje të plotë në ofertën e grupit të rekomanduar për kontratë, i cili në mungesë të qasjes në dokumentacionin e grupit të rekomanduar, i njëjti dyshon që AK nuk ka vlerësuar drejtë, sepse dyshohet se vërtetimi tatimor është më e vjetër se tre muaj, për shkak se porcedura ka tejkaluar tre muaj nga dorëzimi origjinal. Gjithashtu dyshon se qarkullimi nuk është përmbushur, stafi profesional Arkeologu nuk është përmbushur, stafi mbështetës Armiruesin dhe Latuesin kriteri nr. 4, si dhe lista e pajisjeve ekzistojnë dyshime se nuk i plotëson për arsye se nuk kanë poseduar qasjen e plotë.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, sa i përket vërtetimeve tatimore, të njëjtit kanë sjellë vërtetimet brenda afatit kohor si fitues dhe gjithashtu të njëjtat ende janë brenda afatit valide 90 ditë, të cilat gjithashtu janë verifikuar sipas numrit serik në ATK dhe rezultojnë se nuk kanë borxhe dhe janë valide. Të njëjtat vërtetime, AK ka dëshmuar edhe me foto në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

Sa i përket kërkesës për qarkullim, në ofertën e grupit të rekomanduar gjenden deklaratimet të cilat në total konzorciumi arrijnë vlerën dhe tejkalojnë 5 Milion euro. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

Tutje, lidhur me dyshimet sa i përket mos përmbushjes së kërkesës me numër 3, përkatësisht 3.6 Një Arkeolog me Licencë A4 (A4-1 ose A4- 2 ose A4- 3 ose A4-4), të cilën kërkesë grupi i rekomanduar në ofertë kanë të bashkangjitur Master të Arkeologjisë të diplomuar në Francë dhe të bashkangjitur ka edhe Vendimin për Njohte të gradës titullit në vitin 2014, po ashtu ka të bashkangjitur Licencën A4-2 -Pa afat skadimi, 3 Certifikime të tjera relevante me arkeologji dhe trashigimi, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas dosjes së tenderit. Pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

Lidhur me dyshimet për mospërmushje të kërkesës numër 4 të DT-së, të cilat OE ankues dyshon se për shkak të kërkesës për sqarim nga AK, rrjedhimisht OE ankues dyshon se grupi i rekomanduar nuk i plotëson, të cilat ekspertja shqyrtuese ka analizura ofertën dhe përgjigjën në sqarime, duke rezultuar se e plotëson kërkesën, mirëpo AK ka keqkuptuar listën e stafit mbështetës, sepse sipas përgjigjeve të AK-së në sqarime lidhur me Armiruesin dhe Latuesin, në DT është lejuar që të ofrohen me diploma të shkollimit të mesëm me Arkitekturë dhe Ndërtimtari, si e tillë, grupi i rekomanduar ka sjellë një armirues me diplomë të shkollimit të mesëm Ndërtimtari dhe një Latues me diplomë të shkollimit të mesëm Arkitekturë, dhe gjithashtu edhe dy ndihmës armirues dhe latues për të cilët ka bashkangjitur vetëm certifikatat për armirues dhe latues, mirëpo në DT kërkesa ka qenë së paku një, ndërsa grupi i rekomanduar ka sjellë më tepër se një, dhe plotëson kërkesën sipas DT-së. Pretendimi nuk qëndron.

Kërkesa në DT numër 5, lidhur me dyshim për pajisjet dhe Makineritë, ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, grupi i rekomanduar në ofertë kanë të bashkangjitur listën me pajisje, të cilat njëri e posedon me Marrëveshje me qera të noterizuar për projektin në fjalë me vërtetim të nënshkrimeve noteriale, gjithashtu për të tjerat ka sjellë dëshmit sipas dosje së tenderit, andaj pretendimi i OE ankues nuk gjendet i qëndrueshëm.

Si përfundim, Autoriteti Kontraktues analizimin dhe ekzaminimin e ofertave ka vlerësuar konform nenit 1, 6, 7, 59, 72 të LPP-së, duke rezultuar me rekomandim të ofertës sipas kriterit çmimi më i ulët i përgjegjshëm, ndërsa sa i përket mos dhënies së qasjes së plotë nga AK për OE ankuesin, ekspertja shqyrtuese konsideron se, bazuar në paragrafi 3 përkatësisht 3.1, 3.2, dhe 3.3 i nenit 11 të LPP-së, sipas kërkesës në Ankes 3 për Sekrete Afariste nga OE i rekomanduar, AK ka respektuar nenin 11 paragrafi 4 duke dorëzuar një verzion të pastruar të dokumenteve, dhe rrjedhimisht meqë dokumentet e kërkuara janë kërkesat sipas nënit 68 dhe 69, atëherë, ankesa e OE ankues është trajtuar nga eksperti shqyrtues me qasjen në E-Prokurim konform nenit 10 paragrafi 8 i LPP-së.

10.8 LPP- Mjetet për promovimin e Transparencës

8. Autoriteti kontraktues do t'i sigurojë një eksperti shqyrtues, KRPP-së, OSHP-së dhe/ose një paneli shqyrtues, qasje në kopjet e cilitdo aktivitet të prokurimit, duke përfshirë edhe informatat sekrete afariste dhe çfarëdo informata të tjera që kanë të bëjnë me prokurimin, menjëherë pas kërkesës së të mësipërmeve. Autoriteti kontraktues gjithashtu do t'i sigurojë qasje dhe kopje të shënimeve dhe informatave një gjykatë kompetente, nëse qasja ose kopjet e tilla kërkojnë nga një urdhër i nxjerrë nga gjykata e tillë. Autoriteti kontraktues menjëherë do të sigurojë qasjen dhe kopjet e kërkuara në mënyrë të rregullt dhe pa pengesa.

Ankesa e OE ankues rekomandohet që të aprovohet pjesërisht e bazuar për faktin se, në mungesë të qasjes i njëjti dyshon se AK nuk ka vlerësuar drejtë dhe se dokumentet e Grupit të rekomanduar nuk janë ofruar sipas kërkesave të DT-së, mirëpo sipas shqyrtimit të shkresave të lëndës rezulton se grupi i rekomanduar plotëson kërkesat dhe dyshimet e OE ankues nuk qëndrojnë, si e tillë rekomandohet që të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli

Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovet si pjesërisht e bazuar, por e pa mjaftueshme për të ndryshuar epilogun përfundimtar të vendimarrjes së AK. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi njoftimi për dhenie të kontratës të Autoritetit Kontraktues MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - LIMITPROJECT SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: